



Pranuar / Dateduar Prilbhen / Prilbato Received / Dated		06.11.2023		viti god year
Organ / Njesia Organ / Jedinita Org / Unit	Rr. Pref. Rr. Pref. Pref No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SKINSHICK	6887	2023	117	



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1156/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Malsore Gashi-Bajraktari-kryetare, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj-Demi- anëtarë, me Ilire Mehmeti-Shaqiri -Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën A.nr.1156/2022 të datës 13.09.2023, të parashtruar nga ankuesi kundër organit të punësimit/Komuna e Prishtinës, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 dhe 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 06.11.2023, mori këtë:

V E N D I M

I. *Aprovohet si e bazuar* ankesa me numër A.nr.1156/2022 e datës 13.09.2023 e parashtruar nga ankuesi

II. Shfuqizohet Vendimi i datës 01.09.2023 i Komisionit të Vlerësimit lidhur me refuzimin e ankesës së ankuesit, Njoftimi mbi rezultatet përfundimtare i datës 29.08.2023 i nxjerr nga Komisioni Vlerësues në Komunën e Prishtinës për procedurën e pranimit e shpallur sipas Konkursit me Nr. reference:RN00010876 të datës 30.01.2023 për grupin "Specialist të Arkitekturës", për pozitën e punës "Zyrtar i Lartë për Planifikim dhe Zhvillim", ne Drejtorinë e Parqeve ne Komunën e Prishtinës si dhe faza e vlerësimit përfshirë jetëshkrimin dhe intervistën me gojë lidhur me konkursin për pranim me numër reference RN00010876 të datës 30.01.2023 të shpallur nga Komuna e Prishtinës.

III. Obligohet Komisioni i Pranimit i Komunës së Prishtinës i caktuar për këtë procedurë pranimi, që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh të ndërmerr të gjitha veprimet e nevojshme administrative për zbatimin e këtij vendimi ashtu që procedura e rekrutimit me numër referencë RN00010876 të datës 30.01.2023 *kthehet në rishqyrtim nga faza e vlerësimit të jetëshkrimit të kandidatëve* tek Komisioni i Pranimit *gjegjësisht procedura duhet te vazhdoj nga faza e vlerësimit të jetëshkrimit* në pajtim me pikëpamjet juridike sipas këtij vendimi dhe dispozitat ligjore ne fuqi.

IV. Obligohet Kryetari i Komunës së Prishtinës, që t'i ndërmarr të gjitha veprimet e nevojshme administrative, që të bëjë zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi.

V. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim

A r s y e t i m

Komuna e Prishtinës me datën 30.01.2023 ka shpallur konkursin për grup "Specialist të Arkitekturës", për pozitën e punës „Zyrtar i Lartë për Planifikim dhe Zhvillim” në Drejtorinë e Parqeve i cili konkurs ka qenë i hapur nga data 22.02.2023 deri me datën 01.03.2023. Ankuesi ka qenë pjese e procedurës se rekrutimit i cili ka kaluar të gjitha fazat e konkursit i cili sipas renditjes përfundimtare të kandidateve të publikuar ne Sistemin për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore (SIMBNJ) i njëjti është renditur i treti (3), i cili në testin me shkrim ka arrit 61 pikë ne vlerësimin e jetëshkrimit ka arrit 16.5 pikë ndërsa ne intervistën me gojë 8 pikë, e që rezulton me gjithsejtë 85.5 pikë. Komisioni i Vlerësimit në Komunën e Prishtinës me datë 29.08.2023 ka publikuar Njoftimin për kandidati fitues.

Ankuesi pas publikimit të njoftimit të datës 29.08.2023 për kandidatin e përzgjedhur, ka parashtruar ankesë tek organi i punësimit me pretendim se rezultati i jetëshkrimit dhe intervistës me goje nuk ka qene i drejtë, ndërsa kjo e fundit me datën 01.09.2023 i ka refuzuar ankesën e ankuesit si të pa bazuar, mbi bazën e asaj qe Komisioni i Vlerësimit qëndron prapa vlerësimit të intervistës me piket e vendosura ne sistem.

Ankuesi i pa kënaqur me vendimin e datës 01.09.2023 të Komisionit të Vlerësimit ne Komunën e Prishtinës, me datën 13.09.2023 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës me pretendim ankimor se i njëjti në vlerësimin e intervistës me gojë ka marr vetëm 8 pike nga 10 piket pasi që në të gjitha pyetjet ka qenë i saktë po ashtu edhe në vlerësimin e jetëshkrimit i njëjti pretendon se është dashur të vlerësohet me më tepër se 16.5 pike pasi qe ka përfunduar fakultetin adekuat i cili është kërkuar sipas konkursit po ashtu ka eksperience me mbi 7 vite si dhe me rastin e aplikimit i njëjti ka prezantuar certifikatat dhe trajnimet , po ashtu ankuesi pretendon se përmes njoftimit të datës 29.08.2023 te dërguar nga organi i punësimit, i njëjti ka arritur piket e mjaftueshme që të jetë në listën fituese ndërsa pas publikimit të listës figurojnë dy kandidatë të tjerë.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, konform dispozitave Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datën 14.09.2023 ankesën e ankuesit e ka proceduar për përgjigje në ankesë në Komunën e Prishtinës ndërsa Këshilli më datë 22.09.2023 ka pranuar përgjigjen në ankesë me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Sipas kërkesës së anëtarëve të Kolegjit, me datë 27.10.2023 Kryetari i Këshillit ka nxjerrë Vendimin me shifër VK/2023 dhe numër protokolli:6718/2023, përmes së cilit ankesës së ankuesit A.nr.1156/2023 të datës 13.09.2023 ia ka vazhduar afatin vendimmarrës edhe për dhjetë (10) ditë pune.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e ankesave për shqyrtimin e kësaj ankese administroi këto prova: Ankesën me numër protokolli 6070/2023 të datës 13.09.2023 të parashtruara nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Konkursin me numër të referencës RN00010876 e datës 30.01.2023 të shpallur nga Komuna e Prishtinës për Grupin Specialist i Arkitekturës; Njoftimin e datës 09.03.2023 lidhur me listën e ngushtë; Njoftimin e datës 16.03.2023 të U.d. Menaxherit të personelit në Komunën e Prishtinës; Njoftimin e datës 29.08.2023 të Komisionit të Vlerësimit në Komune e Prishtinës; Njoftimin e datës 01.09.2023 lidhur me kandidatin përzgjedhës nga Komisioni i Vlerësimit; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 14.09.2023; Përgjigjen e datës 22.09.2023; Vendimin me numër 14-112/01-151615/23 të datës 24.07.2023 lidhur me përbërjen e komisionit të pranimit në Shërbimin Civil; Akt emërimin me numër 01-nr.112-974 të datës 01.02.2017; Akt emërimin me numër 01-nr.112-997 të datës 01.02.2017; Akt emërimin me numër 01-nr.112-517 të datës 01.01.2023; Akt emërimin me numër 01-nr.112-1191 të datës 21.03.2022; Vendimin me numër 14-020/04-37397/2023 të datës 20.02.2023 për Themelimin e Komisionit të Pranimit në Shërbimin Civil; Vendimin me numër 14-112/02-139255/23 të datës 05.07.2023; Vendimin me numër 14-112/02-94820/23 të datës 11.05.2023 për caktimin e ushtruesit të detyrës; Vendimin me numër 14-112/23-139261/23 të datës 05.07.2023 për caktimin e ushtruesit të detyrës; Vendimin me numër 14-112/02-113627/23 të datës 05.06.2023 për caktimin e ushtruesit të detyrës; Listën e aplikanteve pa datë dhe numër; Rënditjen përfundimtare të kandidatëve të datës 29.08.2023; Formularët e Vlerësimit; Ankesën (pa datë dhe numër) të parashtruar nga ankuesi tek organi i punësimit; Vendimin e datës 01.09.2023 të Komisionit të Vlerësimit; Aplikacionin e datës 27.02.2023 të kandidatit vërtetimin e datës 24.02.2023; Vërtetimin e datës 21.02.2023; Referencën lidhur me përvojën e punës të datës 27.02.2023; Dokumentin e identifikimit; Letër rekomandimin e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës; Certifikatën e datës 09.04.2022; Referencën e datës 27.02.2023 lidhur me përvojën e punës në kompaninë "Mabco Constructions" ShPK; Diplomën e datës 21.05.2002 lidhur me përfundimin e kursit të gjuhës angleze; Certifikatën e datës 07.01.2004 lidhur me përfundimin e kursit të gjuhës angleze; Certifikatën e datës 27.04.2005 lidhur me përfundimin e kursit të gjuhës angleze; certifikatën e datës 09.04.2022; Certifikatën e datës 08.07.2021; Certifikatën e datës 31.01.2023; Diplomën me Nr.1104 të datës 22.04.2015 të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës Fakulteti i Ndërtimitarisë dhe Arkitekturës në Prishtinë; Dokumentin e identifikimit të kandidatës Kontratën e punës të datës 02.11.2011; Letër referencën e datës 30.06.2021; Certifikatën e datës 07.02.2023 me të cilën vërtetohet se kandidatja nuk është e dënuar me aktgjykim të formës së prere; Letër referencën e datës 06.05.2022; Kontratën e punës të datës 13.02.2023; Kontratën e punës të datës 01.02.2023; Kontratën e punës të datës 01.11.2022; Vendimin e datës 27.10.2023 të lëshuar nga Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës;

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, konstatoi së ankesa e ankuesit është e bazuar, sepse:

Ankuesi ne ankesën e parashtruar ne Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës pretendon se i njëjti në vlerësimin e intervistës me goje ka marr vetëm 8 pike nga 10 piket pasi qe ne te gjitha pyjet ka qenë i sakte po ashtu edhe ne vlerësimin e jetëshkrimit i njëjti pretendon se është dashur te vlerësohet me më tepër se 16.5 pike pasi qe ka përfunduar fakultetin adekuat i cili është kërkuar sipas konkursit po ashtu ka eksperience me mbi 7 vite si dhe me rastin e aplikimit i njëjti ka prezantuar certifikatat dhe trajnimet , po ankuesi pretendon se përmes njoftimit të datës 29.08.2023 te derguar nga organi i punësimit i njëjti ka arritur piket e mjaftueshme qe te jete ne listën fituese ndërsa pas publikimit te listës figurojnë dy kandidatë të tjerë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit dhe ka konstatuar se, kërkesat e përgjithshme formale të konkursit me numër reference RN00010876, të datës 30.01.2023 për grupin " Specialist të Arkitekturës "respektivisht për pozitën e punës „Zyrtar i Lartë për Planifikim dhe Zhvillim“ klasa e pozitës „Profesionale 1“ në Drejtorinë e Parqeve në Komunën e Prishtinës, kanë qenë:

- *Arsimimi i kërkuar: Diplomë/a e arsimit të lartë me te pakten 180 kredi/ECTS apo ekuivalente;*
- *Kualifikime të posaçme formale: Fakulteti i Arkitekturës*
- *Përvoja e punës: Se paku dy (2) vite përvojë pune profesionale në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitë së lirë të punës.*

Bazuar në provat e administruara të lëndës, të dërguar nga ankuesi dhe institucioni, Kolegji konstaton se ankuesi me rastin e aplikimit përmes sistemit elektronik, ka kaluar fazën e verifikimit paraprak mirëpo përmes njoftimit të datës 09.08.2023 ankuesi në testin me shkrim ka arrit gjithsejtë 61 pikë ndërsa ankuesi në CV është vlerësuar me gjithsejtë 16.5 pikë, e që nënkupton se ankuesi ka fituar pike 5e mjaftueshme dhe ka arritur që të kaloj në fazën e intervistës me gojë ku është vlerësuar me 8 pikë.

Komuna e Prishtinës përmes njoftimit të datës 29.08.2023 ka shpallur kandidatin fitues në bazë të vlerësimit të Komisionit të Pranimit, ndërsa ankuesi ka parashtruar ankesë pranë Komisionit te Pranimit ne Komunën e Prishtinës kundër vlerësimit të jetëshkrimit dhe vlerësimit të intervistës me goje

Komisioni Vlerësues me datë 01.09.2023 ka marr vendimin përmes të cilit ankuesit i ka refuzuar ankesën me arsyetim qe Komisioni i Vlerësimit qëndron prapa vlerësimit të intervistës me piket e vendosura ne sistem.

Me qëllim të shqyrtimit pretendimeve të ankuesit ndërlidhur me vlerësimin e jetëshkrimit, dhe provave materiale të lëndës, Kolegji i Këshilli, konstaton se anëtarët e Komisionit të Pranimit me rastin e vlerësimit të jetëshkrimit kandidatin e kanë vlerësuar me 16.05 pikë, mirëpo Komuna e Prishtinës respektivisht Njësia e Burimeve Njerëzore pranë Komunës se Prishtinës ka dështuar së dëshmuari se si është bërë vlerësimi i ankuesit në fazën e vlerësimit të jetëshkrimit edhe pse ne kërkesën për përgjigje në ankesë të dërguar nga zyrtarja e KPMSHCK-së janë kërkuar formularët e vlerësimit të jetëshkrimit jo vetëm për ankuesin po për të gjithë kandidatet, të njëjtat nuk janë dorëzuar me përgjigjen në ankese po ashtu me datën 25.10.2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës ka parashtruar kërkesë për prova shtese tek Njësia përgjegjëse në Komunën e Prishtinës mirëpo kjo e fundit ka përsërit përgjigjen duke mos i dërguar prap provat e kërkuara

Lidhur me vlerësimin e jetëshkrimit të ankuesit në dokumentin gjegjësisht vlerësimin përfundimtar të kandidateve ankuesi është vlerësuar me 16.05 pikë edhe përkundër se ankuesi posedon Diplomën me numër Nr.1104/15 të datës 22.04.2015 të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës „ Hasan Prishtina “ me të cilën dëshmohet se ankuesi ka përfunduar studimet themelore universitare në Fakultetin e Ndërtimitarisë dhe Arkitekturës në Departamentin e Arkitekturës me date 02.04.2015 dhe ka marr titullin Baçelor në Arkitekture ashtu siç edhe është kërkuar sipas konkursit me numër të referencës RN00010876, të datës 30.01.2023 , ndërsa lidhur me përvojën e punës dhe certifikatën lidhur me pjesëmarrjen e ankuesit në trajnime i njëjti me rastin e aplikimit ka bashkangjitur tri (3) certifikata si dhe referencën e datës 27.02.2023 të lëshuar me nga kompania “Mabco Construction” shpk ka m me të cilën dëshmohet se ankuesi qene në marrëdhënie pune nga data 05.05.2015 deri me datën 01.03.2021 në pozitën e punës „Arkitekt”; referencën e datës 27.02.2023 të lëshuar nga Invest Group me të cilin dëshmohet se ankuesi ka filluar marrëdhënie pune nga data 01.06.2022 dhe vazhdon të kryej pune në këtë ndërmarrje ne pozitën e punës Arkitekt dhe Mbikëqyrës ne punët finale , andaj ankuesi ka gjithsejtë mbi tete (8) vite përvoje pune, që ndërlidhet me pozitën e punës të kërkuar sipas konkursit me numër të referencës RN00010876, të datës 30.01.2023

Prandaj Kolegji i Këshillit pas analizimit të vlerësimit të jetëshkrimit, ka konstatuar se komisioni i pranimit me rastin e vlerësimit të ankuesit ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 22 paragrafi 2, 3 dhe 4 nën paragrafi 4.1, 4.2 dhe 4.3 të Rregullores Nr.16/2022 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Kosovës ku përcaktohet se: *“2.Vetëm kandidatët që kanë marrë të paktën dyzet (40) pikë në testimin me shkrim, i nënshtrohen vlerësimit të jetëshkrimit. 3.Vlerësimi i jetëshkrimit konsiston në vlerësimin e cilësisë dhe nivelit të arsimimit, të përvojës domethënëse në punë dhe të trajnimeve që lidhen me vendin e punës në lëminë përkatëse të lidhur në Grupin për të cilët zhvillohet konkurrimi. 4.Vlerësimi maksimal për jetëshkrimin është deri në njëzet (20) pikë, të ndara, si vijon: 4.1. deri në tetë (8) pikë për cilësinë dhe nivelin të arsimimit; 4.2. deri në shtate (7) pikë për përvojën domethënëse në punë; dhe 4.3. deri në pesë (5) pikë për trajnimet”,* ndërsa në bazë të këtyre dispozitave Kolegji i Këshillit, ka ardhur në përfundim se anëtarët e Komisionit të Pranimit nuk e kanë vlerësuar ankuesin siç është paraparë në nenin 22 paragrafi 5 të Rregullores Nr.16/2022 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Kosovës, i cili përcakton se *„5.Secili nga anëtarët e Komisionit të Pranimit, bën vlerësimin e detajuar për secilën prej faktorëve të përcaktuara në pajtim me paragrafin 3 dhe 4 të këtij neni. Vlerësimi përfundimtar i jetëshkrimit për një kandidat është mesatarja aritmetike e vlerësimeve e të gjithë anëtarëve,* andaj Kolegji i Këshillit nuk e ka të qartë se si anëtarët e komisionit të pranimit kanë vlerësuar ankuesin me 16.05 pikë të përgjithshme në jetëshkrim duke mos e cekur saktësisht kalkulimin e vlerësimit siç është përcaktuar në dispozitat e lartcekura. Tutje Kolegji konstaton se vlerësimi i ankuesit në jetëshkrim nga ana e Komisionit të vlerësimit me 16.5 pikë për fushat ku ankuesi ka plotësuar kriteret e konkursit është në kundërshtim me dispozitat e nenit 22 të Rregullores

Nr.16/2022 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Kosovës po ashtu Komisioni i Vlerësimit sipas vendimit të datës 01.09.2023 fare nuk e ka shqyrtuar pretendimin e ankuesit lidhur me vlerësimin e jetëshkrimit edhe pse ankuesi e ka kontestuar këtë vlerësim me ankese.

Kolegji i Këshillit po ashtu ka shqyrtuar pretendimin e ankuesit lidhur me vlerësimin e intervistën me goje ku ky i fundit pretendoj se ka dhëne te gjitha përgjigjet e sakta ne intervistën me goje dhe është vlerësuar me vetëm 8 pikë, Kolegji i Këshillit ka analizuar formularët e vlerësimit të intervistës me gojë ku ka gjetur se në Formularin e plotësuar nga anëtarit i komisionit të vlerësimit ka pas ndërhyrje në pjesën e vlerësimit të përgjigjeve tek totali i pikëve respektivisht janë shënuar dhe mandej janë fshire.

Kolegji i Këshillit po ashtu pas analizimit te njoftimit të datës 29.08.2023 ka gjetur se Komisioni i Vlerësimit ka bere shkelje te nenit dispozitave ligjore të Rregullores QRK) NR. 16/2020 25 për Pranim dhe Karriere në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës respektivisht te nenit 25 paragrafi 1 dhe 2 i cili ka përcaktuar se; 1.Komisioni i Pranimit, në përfundim të fazës së vlerësimit të kandidatëve, harton dhe miraton aktin e përfundimit të procedurës të konkurrimit me fitues që përfshin edhe një listë me vlerësimet përfundimtare të të gjithë kandidatëve. Kandidatët renditen në listë sipas rezultatit të vlerësimit përfundimtar në rendin zbritës. Lista i dërgohet Njësisë Përgjegjëse brenda ditës pasuese të punës nga miratimi i saj. 2.Kandidatët që janë vlerësuar me shtatëdhjetë (70) pikë e më shumë, janë kandidatë fitues. Njësia Përgjegjëse publikon listën e kandidatëve fitues në pajtim me nenin 9 të kësaj Rregulloreje. Si dhe nenin 26 paragrafi 7 te rregullores se larte cekur e cila ka përcaktuar se ; 7.Lista e kandidatëve fitues që nuk janë emëruar, është e vlefshme për një periudhë 1 (një) vjeçare nga shpallja e listës të kandidatëve fitues. Nëse gjatë kësaj periudhë organizohet një procedurë tjetër konkurrimi për të njëjtin Grup, kandidatët e listës së mëparshme rirenditen sipas rezultatit të të dyja listave. Sepse me rastin e përpilimit të listës përfundimtare për kandidatin e përzgjedhur Komisioni i Vlerësimit është dashur ti publikoj te gjitha kandidate të cilët kanë arritur 70 pike e më tepër ku ne rastin konkret janë katër (4) kandidatë të cilët kanë arritur 70 e me tepër pikë e te cilët sipas dispozitave të lartë cekura nuk janë publikuar emrat e tyre në listën për kandidatet fitues.

Prandaj, sikurse u tha më lartë, mbi bazën e shqyrtimit të shkresave të lëndës, konstatimeve të dhëna si dhe analizimin e dispozitave ligjore të ligjit material dhe rregullores së lartcekur, Kolegji i Këshillit ka ardhur në përfundimin se Vendimi i datës 01.09.2023 i Komisionit të Pranimit në Komunën e Prishtinës është i paligjshëm sikurse përcaktohet me dispozitat e nenin 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 dhe 1.5 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik: "Një akt administrativ është i paligjshëm nëse: 1.1. është nxjerre në mungesë të autorizimit nga një ligj, sipas paragrafit 2 të nenit 4 të këtij Ligji; 1.3. është rezultat i shkeljes të dispozitave lidhur me procedurën administrative; 1.5. është në kundërshtim me ligjin material", ngase Komisioni i Pranimit nuk ka arritur të shqyrtojë meritorisht pretendimin e palës ankuese.

Nga se u tha si më latë, Kolegji i Këshillit konstaton se ka mbetur në fuqi Konkursi me Nr. Reference: RN00010876 të për grupin "Specialist i Arkitekturës", për pozitën e punës "Zyrtar i Larte për Planifikim dhe Zhvillim", sikurse edhe vlerësimi i rezultateve me shkrim, ndërsa Komisioni i Pranimit duhet të zhvilloj procedurën nga faza e vlerësimit të jetëshkrimit, dhe me rastin e rishqyrtimit të lëndës duhet të respektojë vërejtjet e dhëna juridike në arsyetimin e këtij vendimi.


Kështu që pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 dhe 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.1156/2023

Ilire Mehemti-SHAQIRI


Procesmbajtëse

Malsore-GASHI-BAJRAKTARI


Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit
- Kryetarit të Komunës së Prishtinës;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Prishtinës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.